



Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/23 Nr. i faq./Br.str/No.pg 146

Data/Date/Date 27.10.2023

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 24 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 27.10.2022, miraton këtë:

V E N D I M

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510006-00236-0 në Zonën Kadastrale Bërnjak

- Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës, me Nr. Prot. 02/3132/23, i datës 04.10.2023 dhe merret vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës **P-71510006-00236-0** në Zonën Kadastrale Bërnjak, në sipërfaqe prej 220m² (dyqind e njëzet metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1425m² (një mijë e katërqind e njëzet e pesë metra katror) në vendin e quajtur *grlobërnjakë*, me kulturë livadh i klasës 1, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Blerim (Selim) Nurkasës.
- Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës së cekur në pikën 1 të këtij vendimi, do të jetë: "Këmbimi i pronës private me pronën komunale". Me arsyetimin e vetëm për zgjerimin e hapësirës për rreth kanalit të Rimmikut, për shfrytëzim nga fermerë të zonës.
- Autorizohet Kryetari i Komunës që, komform dispozitave ligjore në fuqi, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
- Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenin 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Kuvendit,
- Shërbimit të Kuvendit,
- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,
- MABL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËSNË RAHOVEC

01Nr.146/23
Datë:27.10.2023

